

**Drejt Fushes Europiane te Arsimit te Larte**  
**Mbledhja e Ministrave Europiane te Arsimit te Larte ne Prage**  
( 19 Maj, 2001)

Dy vjet mbas nenshkrimet te Deklarates se Bolonjes dhe tre vjet mbas Deklarates Sorbonne, Ministrat Europiane per arsimin e larte, qe perfaqesojne 32 nenshkruer, u takuan ne Prage per te rishikuar progresin e arritur dhe per te caktuar drejtimet dhe prioritetet per vitet pasardhese te procesit . Ministrat riafirmuan angazhimin e tyre ndaj objektivit te krijimit te Fushes se Arsimit te Larte European deri me 2010. Zgjedhja e Prages per mbajtjen e kesaj mbledhje eshte simbol i vullnetit te tyre per te perfshire te gjithë Europen ne kete proces nen driten e zgjerimit te Bashkimit European.

Ministrat mirpritën dhe rishikuan raportin ' Avancimi i Procesit te Bolonjes' qe iu ngarkua grupit pasues i cili evidentoi se objektivat e percaktuara ne Deklaraten e Bolonjes jane pranuar gjersisht dhe jane perdorur si nje baze per zhvillimin e arsimit te larte nga shumica e nenshkruerëve ashtu si dhe nga universitetet dhe institucionet e tjera te larta arsimore. Ministrat riafirmuan se perpjekjet per te nxitur levizshmerine duhet te vazhdojne per te mundesuar studentet, mesuesit, kerkuesit dhe stafin administrativ qe te perfitojne nga pasuria e Fushes Europiane te Arsimit te Larte perfshire vlerat e saj demokratike, diversitetin e kulturave dhe gjuheve dhe diversitetin e sistemeve te arsimit te larte.

Ministrat vezhguan konventen e institucioneve te arsimit te larte European mbajtur ne Salamanca ne 29-30 Mars, dhe rekomandimet e Konventes se Studenteve Europiane, qe u mbajt ne Göteborg ne 24-25 Maj, dhe vleresuan perfshirjen aktive te Shoqates te Universitetit European (EUA) dhe Bashkimit Kombetar te studenteve ne europe (ESIB) ne procesin e Bolonjes. Ata verejten dhe vleresuan edhe shume iniciativa te tjera qe do te çojne me tej procesin. Ministrat gjithashtu verejten dhe asistencen konstruktive te Komisionit European.

Ministrat vezhguan se aktivitetet e rekomanduara ne Deklarate ne lidhje me strukturen e gradave shkencore jane trajtuar intensivisht dhe gjeresisht ne shumicen e vendeve. Ata ne veçanti vleresuan avancimin e punes per sigurimin e cilesise. Ministrat njohen nevojën e bashkepunimit per t'ju pergjigjur sfidave te shkaktuara nga arsimi pertej kombeve. Ata gjithashtu njohen nevojën e prespektives te te mesuarit gjate gjithe jetes ne arsim.

**Veprimte te metejshme ne vazhdim te gjashte objektivave te procesit te Bolonjes**

Sikurse beri te njohur Deklarata Bolonjes, Ministrat pohuan se ndertimi i Fushes se Arsimit te Larte European eshte nje kusht per gjallerimin e angazhimit dhe konkuresces te institucioneve te arsimit te larte ne Europe. Ata mbeshteten idene se arsimi i larte duhet te konsiderohet si nje miresi publike dhe eshte dhe do te mbetet nje pergjegjesi (regullat etj.) dhe se studentet jane antare te plote te komunitetit te arsimit te larte. Nga ky kendveshtrim Ministrat komentuan procesin e metejshem si me poshte vijon:

**Adoptimi i nje sistemi te njohur dhe te krahasueshem te gradave shkencore.**

Ministrat inkurajuan fuqimisht universitetet dhe institucionet e tjera te arsimit qe te perfitonin nga legjislacioni kombetar ekzistues dhe mjetet Europiane qe synonin lehtesimin akademik dhe njohjen

profesionale te njesive te kursit, gradave shkencore dhe çmimeve te tjera, ne menyre qe qytetaret mund te perdorin efektivisht kualifikimet e tyre, kompetencat dhe aftesite kudo ne fushen e Arsimit te Larte European.

Ministrat u bene thirrje organizatave ekzistuese dhe rrjeteve te tilla si NARIC dhe ENIC qe te nxisnin ne nivel institucional, kombetar dhe European, njohje te thjeshte, efçente dhe te drejte, duke reflektuar diversitetin e kualifikimeve.

### **Adoptimi nje sistemi te bazuar esencialisht ne dy cikle kryesore**

Ministrat vune re me kenaqesi se eshte trajtuar dhe diskutuar objektivi i nje strukture te gradave shkencore bazuar ne dy cikle kryesore, duke theksuar arsimin e larte ne studimet para dhe mbas marrjes se diplomes. Disa vende tashme e kane adoptuar kete strukture dhe disa te tjere po e konsiderojne ate me interes te madh. Eshte e rendesishme theksojme se ne shume vende gradat *bachelor* dhe *master*, apo gradat e dy cikleve te krahasuara, mund te merren ne universitete ashtu si edhe ne institucione te tjera te arsimit te larte. Programet qe te çojne ne nje grade shkencore, sikurse u konkludua ne ne seminarin ne Helsinki mbi gradat e nivelit bachelor (Shkurt 2001), mund dhe ne te vertete duhet te kene orientime te ndryshme dhe profile te shumta me qellim qe ti pershtaten nje diversiteti individual, akademik dhe nevojave e tregut te punes.

### **Vendosja e sistemit te krediteve**

Ministrat theksuan se per fleksibilitet me te madh ne proceset e te mesuarit dhe kualifikimit eshte i domozdoshem adoptimi i kyçeve te pergjithshme te kualifikimit, mbeshtetur nga nje sistem krediti i tille si ECTS ose nje qe eshte i pershtatshem me ECTS, duke siguruar si mundesine per transferim dhe funksione akumulimi. Sebashku me sisteme te njohura te sigurimit te cilesise, parapergatitje te tilla do te lehtësojne mundesine e futjes se studenteve ne tregun European te punes dhe do te gjallerojne pershtatjen, terheqjen dhe konkurencen e arsimit te larte European. Perdorimi i pergjithshem i nje sistemi te tille krediti dhe i Plotesimit te Diplomes do te nxise progresin ne kete drejtim.

### **Nxitja e levizshmerise**

Ministrat riafirmuan se objektivi i permiresimit te levizshmerise te studenteve, mesuesve, kerkuesve dhe stafit administrativ, i paraqitur ne ne Deklaraten e Bolonjes, eshte i nje rendesie te veçante. Per kete arsye, ato konfirmuan angazhimin e tyre ne ndjekje te procesit te heqjes se te gjitha pengesave drejt levizjes se lire e studenteve, mesuesve, kerkuesve dhe stafit administrativ dhe theksuan dimension social te levizshmerise. Ato verejten mundesite per levizje te ofruara nga programet e Komunitetit European dhe progresin e arritur ne kete fushe, p.sh. ne fillimin e Planit Veprimi te Levizshmerise i mbeshtetur nga Keshilli European, ne Nice, ne vitin 2000.

### **Nxitja e bashkepunimit European per sigurimin e cilesise**

Ministrat njohen rolin e rendesishem qe luajne sistemt e ruajtjes se cilesise ne sigurimin e standarteve te cilesise te larte dhe ne lehtësimin e krahasueshmerise te kualifikimeve kudo ne Europe. Ato gjithashtu inkurajuan bashkepunim me te ngushte midis njohjes dhe rrjeteve te sigurimit te cilesise. Ata theksuan domozdoshmerine e bashkepunimit te ngushte European dhe

besim reciprok dhe pranimin e sistemeve kombetare te sigurimit te cilesise. Me tej, ata inkurajuan universitetet dhe institucionet e tjera te arsimit te larte te perhapin shembuj te praktikes me te mire dhe te hartojne skenare per pranim te perbashket te mekanizmave te vleresimit dhe te akreditimit/çetifikimit. Ministrat u bene thirrje universiteteve dhe institucioneve te tjera te arsimit te larte, agjensive kombetare dhe Rrjetit European te Sigurimit te Cilesise ne Arsimin e Larte (ENQA), ne bashkepunim me organizma korrespondues nga vende qe nuk jane antare te ENQA, te bashkepunojne ne krijimin e nje strukture te perbashket te referimit dhe te perhape shembuj te praktikes me te mire.

### **Nxitja e dimensioneve Europiane ne arsimin e larte**

Me qellim qe te forcoje me tej dimensionet e rendesishme Europiane te arsimit te larte dhe diplomimit me mundesi per punesim, Ministrat i bene thirrje sektorit te arsimit te larte te rrise zhvillimin e moduleve, kurseve dhe kurrikules ne te gjitha nivelet me permbajtje, orientim dhe organizim 'European'. Kjo perfshin veçanerisht modulet, kurset dhe kurrikula te gradave shkencore te ofruara ne partneritet me institucionet nga vende te ndryshme dhe qe do te çojë drejt njohjes se nje grade shkencore te perbashket.

Me tej Ministrat theksuan çeshtjet e meposhteme:

#### **Te mesuarit gjate gjithë jetes**

Te mesuarit gjate gjithë jetes eshte nje element i rendesishem i Fushes se Arsimit te Larte European. Ne Europen e te ardhmes, e ndertuar mbi nje shoqeri dhe ekonomi te bazuar ne dijet, strategjite e te mesuarit gjate gjithë jetes jane te domozdoshme per te perballuar sfidat e konkuresces dhe perdorimin e teknologjive te reja dhe per te permiresuar kohezionin shoqeror, mundesite e barabarta dhe cilesine e jetes.

#### **Institucionet e arsimit te larte dhe studentet**

Ministrat theksuan se eshte e nevojshme dhe e mirepritur perfshirja e universiteteve dhe institucioneve te tjera te arsimit te larte dhe e studenteve si partnere te afte, aktive, dhe konstruktive ne krijimin dhe formimin e Fushes se Arsimit te Larte European. Institucionet kane demonstruar rendesine qe ata i japin krijimit te nje Fushes te Arsimit te Larte European te pajtueshme dhe efeçente, ende diversive dhe te adoptueshme. Ministrat gjithashtu theksuan se cilesia eshte kushti baze ne themel te besimit, levizshmerise, pershtatjes, dhe terheqjes ne Fushen e Arsimit te Larte European. Ministrat shprehen vleresimin e tyre per kontributet ndaj zhvillimit te programeve te studimit nepermjet kombinimit te cilesive akademike qe lidhen me mundesine per punesim afatgjate dhe bene thirrje per nje rol te vazhdueshem proaktiv te institucioneve te arsimit te larte..

Ministrat pohuan se studentet duhet te marrin pjese dhe te ndikojne ne organizimin dhe permbajtjen e arsimit ne universitete dhe institucione te tjera te arsimit. Gjithashtu, Ministrat riafirmuan nevojen, e ri-kerkuar nga studentet, per te patur parasysh dimensionet sociale ne procesin e Bolonjes.

#### **Nxitja e perfshirjes ndaj Fushes se Arsimit te Larte European**

Ministrat miratuan rendesine e gjallerimit te perfshirjes ne arsimin e larte European te studenteve nga Europa dhe pjese te tjera te botes. Njohja dhe krahasimi i gradeve shkencore te arsimit te larte

European ne te gjithë boten duhet te gjallërohet nga zhvillimi i nje kuadri te perbashket te kualifikimeve, ashtu si edhe nga sigurim i cilesise koherente dhe mekanizmave te akreditim/çertifikimit dhe nga rritja e perpjekjeve per informacion.

Ministrat ne veçanti theksuan se cilesia e arsimit te larte dhe puna kerkimore eshte dhe duhet te jete nje percaktues i rendesishem i konkuresces dhe perfshirjes nderkombetare te Europes. Ministrat miratuan se me shume vemendje duhet te tregohet ne dobi te krijimit te nje Fushe te Arsimit te Larte European me institucione dhe programe te profileve te ndryshme.

Ato bene thirrje per rritje te bashkepunimit midis vendeve Europiane lidhur me implikimet e mundshme dhe perspektivat e arsimit nderkombetar.

### **Veprimtari vazhduese**

Ministrat u angazhuan per te vazhduar bashkepunimin e tyre bazuar ne objektivat e paraqitura ne Deklaraten e Bolonjes, duke ndertuar mbi ngjashmerite dhe duke perfituar nga ndryshimet midis kulturave, gjuheve dhe sistemeve kombetare, dhe duke perdorur te gjitha mundesite e bashkepunimit nderqeveritar dhe dialogut te vazhdueshem me universitetet Europiane dhe institucionet te tjera te arsimit te larte dhe organizatat te studenteve ashtu si dhe me programet te Komunitetit.

Ministrat mirepritën antaret e rinj te bashkoheshin me procesin e Bolonjes mbas aplikimeve nga Ministra qe perfaqesonin vendet per te cilat jane hapur programet Soctrates dhe Leonardo da Vinci ose Tempus-Cards. Ata pranuan aplikimet nga Kroacia, Qipro dhe Turqia.

Ministrat vendosen se nje mbledhje pasuese do te zhvillohej ne gjysmen e dyte te 2003 ne Berlin per te rishikuar progresin dhe per te caktuar objektiva dhe prioritete per fazat e tjera te procesit drejt Fushes te Arsimit te Larte European. Ata konfirmuan nevojën per nje strukture pune pasuese, qe do te konsistonte ne nje grup pasues dhe nje grup pergatitor. Grupi pasues duhet te perbehej nga perfaqesues te te gjithë nenshkruesve, pjesmarres te rinj dhe Komisioni European, dhe duhet te drejtohej nga Presidenca EU e kohes. Grupi pergatitor duhet te perbehej nga perfaqesues te vendeve pritese te mbledhjes se meparshme ministeriale dhe mbledhjes se ardhshme ministeriale, dy antare shteti EU dhe dy jo-antare shteti EU; keta kater perfaqesues te fundit do te zgjidhen nga grupi pasues. Presidenca EU e kohes dhe Komisioni European do te jene gjiashu pjese e grupit pergatitor. Grupi pergatitor do te drejtohet nga perfaqesuesi i vendit ku do te mbahej mbledhja e ardhshme ministeriale.

Shoqata e Universitetit European, Shoqata Europiane e Institucioneve ne Arsimin e Larte (EURASHE), Unionet Kombetare te Studenteve ne Europe dhe Keshilli i Europes duhet te konsultoheshin ne veprimtari vazhduese.

Per te çuar me perpara procesin, Ministrat inkurajuan grupin pasues te organizonte seminare per te eksploruar fushat e meposhteme: bashkepunim ne lidhje me akreditimin dhe sigurimin e cilesise, çeshtje njohese dhe perdorimi i krediteve ne procesin e Bolonjes, zhvillimi i gradeve shkencore te perbashketa, dimensionin social, me vemendje te veçante ndaj veshtiresive te levizjeve, dhe zgjerimit te procesit te Bolonjes, te mesuarit gjate gjithë jetes dhe perfshirjes se gjere te studenteve.

**Translated by: Adriana Bisha**

**Perkthyer nga: Adriana Bisha**

**Translation was enabled by SEE ECN.  
Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.**